

Buletini

TETOR 2023



Nis projekti madhor në Lipjan, mbi 6 milion euro investim në qendrën e qytetit

Kanë filluar punimet në projektin më të rëndësishëm infrastrukturor në qytetin e Lipjanit - Ndërtimi i nënkalimit, vazhdimi i ndërtimit të sheshit, ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, zotimin e tij para qytetarëve lipjanas për fillimin e realizimit të këtij projekti e vlerësoi si më të rëndësishmin në Lipjan i cili do ta transformoj qytetin në një qendër në funksion të mirëqenies së qytetarëve.

“Është një ndër projektet më madhore të qytetit të Lipjanit që besoj që do të ja ndërroj pamjen tërësisht qytetit. Ne kemi identifikuar nevojën e madhe të parkingut, nevojën e madhe të parkut, pastaj integrimin e sheshit dhe zgjidhjen e problemeve të trafikut. Janë katër projekte të integruar në një projekt”, ka thënë Kryetari Ahmeti duke bërë të ditur se projekti do të zgjasë rreth tre vjet.



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi nga Komuna e Lipjanit ka mbajtur takim të përbashkët me KKSB-në nga Komuna e Fushë – Kosovës ku u bë shkëmbimi i praktikave më të mira ndërmjet dy KKSB-ve.

Ky takim u organizua me përkrahje të OSBE-së dhe ishte takimi i pestë me radhë i KKSB – Lipjan dhe i pari takim ndërkomunal i KKSB-ve në Kosovë.



KONKURS PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË

Komuna e Lipjanit ndanë 170 bursa për studentë për vitin akademik 2023/2024 në vlerë prej 500 euro.

Konkursi është publikuar më data 29 shtator 2023 dhe zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit.



Komuna e Lipjanit ndanë **170 BURSA** nga **500** euro
për studentët e vitit akademik 2023/2024

APLIKONI PËR

BURSA

Në kuadër të muajit tetor, muajit të ndërgjegjësimit për parandalimin e kancerit të gjirit, Drejtoria e Shëndetësisë ju njofton se Mamografi Mobil do të vie në Lipjan prej datës 18 tetor deri më 20 tetor 2023.

Mamografi mobil do të vendoset pranë Sektorit të Radiologjisë në QKMF Dr. Mehdi Zejnullahu në Lipjan.

Shërbimet gjatë këtyre tri ditëve do të ofrohen nga ora 08:00 deri në ora 20:00. Andaj, të nderuara Gra të Komunës së Lipjanit, ju lutem të regjistroheni në listën për mamografi në Sektorin e Radiologjisë.

Përgjegjëse për regjistrimin e juaj, mbajtjen e kontaktit me ju dhe për të ju informuar për datën dhe orën kur do të caktohet termini juaj është motra Gane Zejnullahu.



NJOFTIM

18.10.2023
20.10.2023

QKMF Dr. Mehdi Zejnullahu, Lipjan

08:00
20:00

Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Lipjanit, z.Valon Pacolli po merr pjesë në konferencën e liderëve të zhvillimit ekonomik të Ballkanit Perëndimor e më gjerë në kuadër të programit BFC “Core days” 2023 dhe komunave të këtyre rajoneve, financuar nga qeveria Suedeze.

Konferenca po zhvillohet në Kotor të Malit të Zi, ku të pranishëm përveç komunës së Lipjanit janë nga komuna e Ferizajit, Kamenicës, Pejës, Prizrenit dhe Gjakovës si dhe komuna nga të gjitha vendet e rajonit, përfshirë udhëheqës të institucioneve publike e private nga Tirana dhe qytetet tjera të Shqipërisë, Malit të Zi, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut.

Nga kjo konferencë u konfirmua se Komuna e Lipjanit është ndër komunat e para që është e kualifikuar për të vazhduar me procesin e çertifikimit ndërkombëtarë për një ambient të mirë të të bërit biznes dhe si komunë miqësore me bizneset.



Fushatë vetëdijesuese për kancerin e gjirit

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi i është bashkuar marshit me moton “Zbulimi i hershëm shpëton jetë”, të organizuar nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesie Sociale në bashkëpunim me Grupin e Grave në kuadër të aktiviteteve ndërgjegjësuese për kancerin e gjirit.

Nënkryetari Bytyqi tha se është shumë e rëndësishme që të gjithë së bashku të përçojmë mesazhin që t’i kushtojmë kujdes e vëmendje më të madhe shëndetit për të diagnostifikuar sa më herët sëmundje të tilla.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti së bashku me nënkryetarin z. Diamant Bytyqi, kanë pritur në takim z. Noel Bauer, drejtor i të gjitha aktiviteteve të USAID në Kosovë për Qeverisje dhe Demokraci si dhe përfaqësues të tjerë të USAID-it nga programi Integriteti i Komunave të Kosovës si dhe programi Qeverisja e Pronës.

Me këtë rast Kryetari z. Imri Ahmeti, ka informuar z. Noel Bauer lidhur me ecurinë e implementimit të projekteve Integriteti i Komunave të Kosovës dhe Qeverisja e Pronës të cilat po zhvillohet në Komunën e Lipjanit.

Kryetari z. Imri Ahmeti po ashtu ka falënderuar ekipin e USAID-it për bashkëpunimin dhe asistencë profesionale në ndërtimin dhe ngritjen e standardeve të punës në sektorë të ndryshëm si auditim të brendshëm, prokurim, implementimin e projekteve kapitale dhe buxhetin.

Nga ana tjetër, z. Noel Bauer, drejtor i të gjitha aktiviteteve të USAID në Kosovë për Qeverisje dhe Demokraci ka falënderuar Kryetarin Ahmeti dhe Komunën e Lipjanit për bashkëpunimin e mirë në realizimin e aktiviteteve që po zbatohen në Komunën e Lipjanit në kuadër të projekteve të financuar nga komuna dhe USAID-i.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim përfaqësuesit nga zyra e UNMIK-ut në Kosovë, Margarethe Matic, Shefe e Zyres per Përkrahje të Komunitetit së bashku me Steffen Felbrich, Shef i Ekipit për regjionin e Prishtinës të shoqëruar nga Bashkim Ibishi Drejtor Ekzekutiv nga OJQ 'Advancing Together'.

Gjatë takimit kanë diskutuar një varg çështjesh që nderlidhen me komunitet që jetojnë në Komunën e Lipjanit dhe aktivitetet e përbashkëta që do të realizohen për fuqizimin e këtyre komuniteteve.

Ndërsa në fund të takimit Kryetari Imri Ahmeti dhe Bashkim Ibishi Drejtor Ekzekutiv nga OJQ 'Advancing Together', kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për zbatimin e Projektit “Bëhu Partneri Im për Mirëqenie”, për fuqizimin e komuniteteve lokale, duke kontribuar kështu në hartimin, zbatimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve dhe projekteve në lidhje me komunitetet.



FOTLOLAJM/Mamografi mobil është vendosur në Lipjan pranë Sektorit të Radiologjisë në QKMF Dr. Mehdi Zejnullahu dhe do të qëndroj deri të premten, ndërsa gjatë këtyre tri ditëve do të ofrohen shërbimet sipas agjendës së planifikuar.



Drejtori i Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Lipjanit, z. Valon Pacolli i shoqëruar nga Drejtori për Bujqësi z. Rexhep Rexhepi kanë vizituar disa nga bizneset që operojnë në Komunën e Lipjanit, për të parë nga afër aktivitetin e tyre dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ato gjatë punës së tyre. “Oriental Mushrooms”, “Magic Ice”, “Shkritorja 1” në Janjevë, “Poppins”, ”ScanTech”.



Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Lipjanit, në sallën e Kuvendit të Komunës ka mbajtur debat të hapur publik me përfaqësuesit e bizneseve lidhur me projekt rregulloren për orarin e punës së veprimtarive ekonomike në territorin e Komunës së Lipjanit.

Me këtë rast, Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim z. Valon Pacolli, tha se Komuna e Lipjanit është e interesuar që të ketë një rregullore gjithëpërfshirëse e të përshtatshme për bizneset, punëtorët dhe konsumatorët dhe nga ky takim pret propozime konkrete nga pjesëmarrësit sa i përket ndryshimeve që do të bëhen.



Në kuadër të aktiviteteve “Tetori – Muaji i mundësive të barabarta profesionale për personat me aftësi të kufizuara”, në ambientet e bibliotekës së qytetit në Lipjan, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale së bashku me Njësitin për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore organizuan tryezë diskutimi me personat me nevoja të veçanta me qëllim të ngritjes së vetëdijes për këtë kategori të çmuar të shoqërisë sonë.

Po ashtu në mbështetje të këtyre personave ditë më parë Kryetari Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti ka mbështetur 20 persona me aftësi të kufizuara, për të qenë pjesë e stafit Komunal për dy ditë radhazi.



Komiteti për Komunitete ka mbajtur mbledhjen e 19-të me radhë, të cilën e kryesoi Skender Bikliqi dhe u shqyrtuan pikat të cilat ishin të propozuara për rend të ditës.

Drejtori për Shëndetësi dhe Përkujdesie Sociale, z. Shkelzen Hajdini ka njoftuar anëtarët e këtij komiteti për punët e deritanishme të realizuara në sektorin e shëndetësisë.

Gjatë kësaj mbledhje është diskutuar edhe raporti i punës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, prezantuar nga Koordinatorja për Kthim të Qëndrueshëm, Lidia Jovanoviç.

Në mbledhjen e mbajtur sot u diskutuan edhe tema të ndryshme që kanë të bëjnë me komunitetet jo shumicë që jetojnë në komunën tonë.



Në sallën e Kuvendit të Komunës, është mbajtur debat publik për Draft – Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal 2023 – 2031 për Komunën e Lipjanit, dokument ky që synon zbatimin e qëllimeve, objektivave dhe prioriteteve strategjike në përputhje me kriteret për mbrojtje mjedisore dhe për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Me këtë rast Drejtori për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, z. Imri Semetishti tha se Komuna e Lipjanit është në vazhdim të procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal për periudhën e ardhshme 8 vjeçare. Ai tha se tashmë Komuna e Lipjanit ka hyrë në fazën përfundimtare të hartimit të PZHK-së dhe përmes këtij dokumenti që u prezantua sot e që është në fazën e konsultimit publik, janë përcaktuar objektivat dhe prioritete e Komunës së Lipjanit për mbrojtjen e mjedisit.



KPF ka mbajtur mbledhjen e 20-të me radhë

Nën udhëheqjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, z. Daut Azemi, në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit është mbajtur mbledhja e 20-të e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), ku u prezantuan dhe u diskutuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Anëtarët e këtij komiteti kanë rekomanduar të gjitha pikat e rendit të ditës për mbledhjen e 23-të të Kuvendit të Komunës që mbahet më 30 tetor 2023, nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit Komunal.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, ka pritur në një takim Prof. Dr. Ruth Seifert dhe Prof. Dr. Irmgard Schroll – Decker nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Regensburg të Gjermanisë.

Nënkryetari Bytyqi shprehu falënderimin për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm dhënë për Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, në veçanti në fushën e shkencave sociale, me theks të veçantë në themelimin e departamentit të shkencave sociale.

Në shenjë respekti, nënkryetari u dhuroi llogon e komunës së Lipjanit. Përveç kësaj, pas takimit, profesoret dhe përfaqësues të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Lipjanit vizituan Drejtoratin e Shëndetësisë dhe Shtëpinë me Bazë në Komunitet.



Udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, Kuvendi i Komunës së Lipjanit, ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 23-të me radhë, në të cilën me shumicë votash u aprovuan të gjitha pikat e rendit të ditës.


Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, gjatë kësaj seance ka dhënë sqarime rreth çështjeve të ndryshme që kanë ngritur anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Gjatë punimeve të kësaj mbledhje janë aprovuar këto pika të rendit të ditës:

Raporti i shpenzimeve dhe i të hyrave janar –shtator 2023.



Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë